ADEM ZAPLLUZHA

MË MIRË NJË GJYSMË ËNDRRE

Redaktor:
Bedri Neziri

Recensent:
Agron Shele, poet

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

MË MIRË NJË GJYSMË ËNDRRE

"TREND"
2016

Epika dhe tragjikja në poezinë e Adem Zaplluzhës

Nga Agron Shele

Karakteri epiko- tragjik i artit kosovar, është i lidhur ngushte me përvuajtjen dhe martirizimin e një populli për liri dhe pavarësi, dhe si i tillë ai hedh dritë jo vetëm mbi atë të shkuar dramatike, që për nga përmasat kalon dhe dhimbjet biblike, por i shërben dhe kujtesës kombëtare, që akte të tilla makabre të mos përsëriten më. Nën këtë vazhdë dhe përbrenda kësaj tradite vjen dhe arti poetik i autorit të njohur, Adem Zaplluzha, i cili me fjalën e tij artistike e ngre sublimitetin e atdheut të vet në faqen më të ndritshme të panteonit historik . Që në fillim duhet theksuar se vepra e këtij autori ka dimensione dhe përmasa të pakufishme, vjen e plotësuar dhe kapërcen gati të gjitha zhanret, është voluminoze duke përbërë kështu një enciklopedi më vete, dhe e gjithë kjo risi krijuese përshkohet nga një bosht i mirë përcaktuar, nga një frymë koherente filozofike dhe ide e konsoliduar. Tematika e larmishme sjell shpesh tabllot e gjalla të ngjarjeve që kanë ndodhur, të cilat ashtu sikurse janë dhe në kohezion me realitetin gri shprehin jo vetëm lajtmotivin e atdhedashurisë, lirisë dhe të

drejtave humane e njerëzore, por dhe konceptin e vetë pjekurisë intelektuale dhe artistike të vetë autorit. Vëllimi poetik " Më mirë një gjysmë ëndrre" ndahet në tre cikle, dhe për nga ndërthurja dhe ndërtimi vlen të veçosh idetë madhore dhe ritmin e lartë që ndjekin këto krijime.

1- Cikli i parë poetik hapet me poemën epike-tragjike **"Le ta ndiej veten si në Tivar".** E gjithë arena kombëtare, por dhe ajo ndërkombëtare janë njohur me këtë masakër nga më të tmerrshmet të ndodhura në Tivar, ku faktet historike, hedhin dritë për kufijtë e paimagjinueshëm të urrejtjes sllave, e cila në bashkëpunim me terrin e kuq komunist shqiptar, në mënyrë djallëzore dhe të pabesë vrau lulen e rinisë kosovare. Se deri ku arrijnë kufijtë e kësaj dhimbjeje, këtij krimi kaq monstruoz dhe të njohur botërisht, e shprehin vargjet e autorit, të cilët nuk ravijëzohen thjesht si metrikë poetike, por si elegji që do jehojë në jetë të jetëve pafajësinë e shpirtrave të tyre heroikë.

" Në Tivar pamë varre të mbjellë mbi varr
Vetëm një dorë mizore
Me shpirt bishe
Mund të gjuajë batare plumbash
Në njerëz duarlidhur
Me prangat pafajësisë"

Që në fillim ndeshemi me përmasat e kësaj dhimbjeje apokaliptike, këtij pikëllimi të pakufi **“ varre të mbjellë mbi varr”,** ku pabesia, mizoria dhe ligësia çnjerëzore godet dhe mbjell vetëm vdekje. Autori, si misionar i ndërgjegjes së popullit të tij ngre akuzën e madhe për këtë kryetragjedi dhe nga përtej shpirti i tyre kërkon drejtësi hyjnore. Kjo dorë mizore do të përsëritej dhe në luftën më të fundit në Kosovë, luftë e cila e sprapsi përfundimisht perversitetin e qytetërimit evropian “ perversitetin sllav” dhe hapi tjetër perspektivë për popullin martir shqiptar-kosovar.

Dhe në përmbyllje të kësaj poeme, poeti nuk mund të dalë jashtë ndjesive dhe perceptimit të tij, por kërkon të shkrihet bashkë me të, të bëhet pjesë e saj, asht i ashtit të tyre.

“Nëse nuk mund të të ofroj asgjë
Merre këtë copë të ashtit të thyer
Vendose diku në ndonjë varr
Merre hisen tënde
Le ta ndiej veten si në Tivar”

Kuptimi i kësaj poeme shkon dhe më larg dhe për më tepër shërben si thirrmë për brezat që do vijnë, të cilët duhet të njohin sakrificën dhe rrugën e gjakut të paraardhësve të tyre, si dhe të bëhen mbrojtës të lirive, principit njerëzor dhe krenarisë kombëtare shqiptare, si krenari e trashëguar që nga fiset ilirike.

2- Në ciklin e dytë autori bën një kapërcim të madh poetik duke u përqëndruar tek mesazhi poetik, si frymë dhe burim shenjtërimi shpirti, por dhe si koncept dhe filozofi mendimi. Gjithashtu nëpërmjet formave dhe gjetjeve shpreh botëkuptimin ideo-artistik, si identifikim të artit që e veçon, por dhe risisë letrare që krijon.

"Ne të gjithë jemi të gjykuar
Të jetojmë mes ëndrrave
Vetëm me një gjysmë vegimi
Kurse gjysma tjetër i takon futurizmit."

Këto vargje shprehin qartë edhe idilin udhëheqës të autorit, sikurse është futurizmi, fluiditeti i lajtmotiveve edhe kontrasteve të fora, të cilat shembin ç' do traditë të shkuar për të shprehur modalitetin por dhe tendencat e absorgimit të sotëm.

3- Ndërsa cikli i tretë dhe i fundit rikthehet me një tjetër stilistikë tek boshti i përshkrimit poetik të gjithë veprës; si : plagëve të luftës, qytetit të djegur, himnizimit të martirit, marshimit përmes Sharrit, etj. Nëpërmjet vargjeve të lira, fuqisë shprehëse, kompozicionit, anës metaforike dhe frymëzimit të lartë, zëri autentik i poetit ngrihet në kurbaturën dhe nivelin më të lartë dhe që nga maja e kësaj thagme ai deshifron pareshtur epopenë e popullit të tij.

“Besoj se nuk mbani hidhërim
Për skamjen tonë
Ishim në gjendje t’jua jepnim frymën
Edhe ju e dini se për luanët e lirisë
Ne nuk e kursyem
As gjakun e fëmijëve, të fëmijëve tanë”

Poezia e tij në këtë vepër vjen si prelud dhe moderaturë bashkëkohore, pasi ndërthurja e epikës me skematizimet e poetikës moderne, e bën sa intrigues po kaq dhe të veçantë për llojin e gjinisë që shkruar dhe origjinalitetin që përcjell.

Autori Zaplluzha është publikues i 133 veprave letrare, i qindra artikujve dhe pjesëmarrës i shumë antologjive letrare, prurje kjo që të impresionon por dhe befason, dhe për më tepër të bën të kuptosh se madhështia e artit të tij i ka bërë shërbimin më të çmuar fonetikës së letrave shqip.

Le ta ndiej veten si në Tivar
Cikli i parë

LE TA NDIEJ VETEN SI NË TIVAR

Në Tivar
Me mallëngjim po dënes një varr
Dy shtatë shtatëdhjetë mijë dhembje
Si delet e bardha
Kullosin mbi plagët e një kohe

Në Tivar pamë varre të mbjellë mbi varr
Vetëm një dorë mizore
Me shpirt bishe
Mund të gjuajë batare plumbash
Në njerëz duarlidhur
Me prangat pafajësisë

Ne Tivar
Atë ditë fshikullonte mortja
Ishte viti 1945 mos u ktheftë më
Vetëm ky qytet i vdekjeve
I njeh trishtimet e asaj dite
Të vrarë me thikat e urrejtjes

2.

Në një qytet plagësh
Në prehrin e Adriatikut
Qante gjaku i kuq mbi varr
Era dëneste në rrënjët e fikut

Një kryq i ngulur në shpirtin e qytetit
Thërret ndërgjegjen e njerëzimit
Në Tivar
Ra në provim raca njerëzore

Ishte nata e trishtë
Ajo e lugetërve
Me bisht
Era lëpinte lëkurën e frikës

Nga majat e thikave të topitura
Pikonte gjaku i gjelbër
Mbi njomësinë e barit
Llamburitnin velat e trishtuara të historisë

Nën çatitë e përlotura mpiksej truri
Si foshnjat dënesnin lagjet e gjakosura
Një pulëbardhë mbi një varr
I shkulte pendlat atë ditë në Tivar

3.

Thonë se si një kalama
Jetim
Atë ditë ka dënesur
Ka dënesur me ngashërim bunaca

Thika e ndryshkur e tradhtisë
Fundosej deri në grykë
Fundosej hajnisht
Në gjakun e njomë të ushtarëve të lirisë

Mbi një degë të palmës së egër
Ende vajton një nënë
As vajet e pulëbardhave
Nuk ndalen në lagunë

Adriatiku si nënat tona
I shkulte flokët e shprishura të ditës
I shkulte por vështirë
Se mund të shkulej tradhtia

4.

Çatitë e mrrolura qëndronin stepur
Oxhaqet me mendje të ngrirë
Në shenjë proteste
I ndalën ato pak vrizma të tejdukshme
Të tymit dredharak

Nëpër lagjet shqiptare
Ndihej aroma e rënd e gjakut
I tërë qyteti
Ishte veshur me veladon të bardhë

Si fantazmat e së kaluarës
Vraponin lukunitë e kuqe
Të ujqërve të egër

Asnjë nënë nëpër mëhallët e Tivarit
Nuk pashë
Pa shamia të bardha mbi kokë

Të bardha ishin shpresat e gjakosura
Një pulëbardhë e plagosur
E mbante gjallë shpirtin
Me vezët e saja të thyera

5.

Po më djegin si prush tangari
Po më përvëlojnë
Thinjat e këputura të flokëve
Djajtë me kryqe të thyera
I shkulnin rrapet

Binin në tokë me qindra plepa të prerë
Një mjegull e zezë katran
Si mortja rëndohej mbi supet e atdheut

Mbaju moj nënë
Me dhembjen e cilës grua
Sonte do i dëgjoj këngët e tua vajtimore

Nisja njëherë moj loke
Nisja si dikur
Le të qajnë tok me ty drurët dhe gurët
Nëno moj krijesë shelgje e lotuar
Kurrë nuk t'u shëruan plagët e dhembjeve

Nëpër ledhat e trishtuara të historisë
Vajtove kur e linde motrën time
Nuk t'u ndalë vaji
As kur e pushkatuan bacën në Tivar

6

Nëpër kryeqytete
Festonin fantazmat e dehura
Me gjak njeriu
Nënat tona flokëthinjura
Pa shamia në kokë vraponin xhadeve
Vaji ishte i vetmi shërim i shpirtit të vrarë

Për ta mposhtur vdekjen
Mbanim nëpër trasta nga një gur varri
U dolëm në bejleg gjakpirësve
Çdo ditë nga pak rritej orteku i urrejtjes
Rritej si oshtimë deti uturima e dhembjes

Sërish nëpër fushat e mëllenjave
Filluan të dëgjohen ulërimat e bishave
Nuk dinin të ndalen
As krakëllimat e zeza të korbave
Si shtatë shpirtra të vrarë ulërinte nata

Era e mbështetur për trungun e rrapit
I mbante në kujtesë plagët e një kohe
Dhe sa krenare
Po aq edhe madhështore
I mëkonte zanat e malit
Për një betejë përfundimtare

7.

Çdoherë nëpër fushat e Tivarit
Rikthehen pulëbardhat
Rikthehen si zogjtë krahthyer
Për ta lënë peng amanetin
E gjakut të derdhur
Nga i cili akoma
Nuk ka pushuar dhembja e nënave

Mbrëmë në Tivar
Dëgjova se si dëneste një varr
Qante edhe një nënë e moshuar
Nga zgavrat e saja të verbëta
Pikonte një lloj malli i pashëruar

Dy pemë të njoma
Sapo kishin filluar rritën
U kafshuan deri në asht
Nga dy bisha
Por kafshimet më nuk kullojnë gjak
Por s'kanë takat as urrejtje të kullojnë

8.

Mbi një varr të vithisur
Diku në brigjet e Adriatikut
Atje poshtë në Tivar
Nuk gjeta fjalë për të qarë

Thellë nga thellësia
E fushës së mëllenjave
Si një ogur i zi
Pandërprerë vjen një jehonë

Ndoshta është koha
Ta shfletojmë
Për së mbari ose për së mbrapshti
Sërish historinë tonë

9.

Deshëm që nën gërmadhat
E harresës
Ta gjejmë atë pergamenë
Të lashtësisë së fshehur
Nga një dardan
Të ruajtur në parzmën e kësaj toke
Një diademë

Nëpër fushat dhe malet e thepisura
Asnjëherë nuk humbin drurët
Përkundrazi gjethet lëshojnë lastarë
Që i mbërrijnë fundet e deteve
Një ditë
Do të mbërrijnë edhe në Tivar

Do bisedojnë me dhembjet fosforeshente
Eshtrat e bijve tanë
Do bëjnë dritë mbi çdo varr
Do çelin një ditë këtu
Lulet më të bukura të botës në Tivar

10.

Po qe se një ditë dal nga mendja
E të marr me vete atdheun tim
Do i kalojmë shumë dete
Me dallgë dhe trishtim
Ti për mua do të jesh
Përherë vetëm një pikëllim

Askund në botë s'ka gjelbërim
Si këtu në Tivar
Bozhuret rriten dhe lëshojnë lastarë
Të njomur me gjak mbi çdo varr
Si mund të të lë kështu plaga ime e pashëruar

Unë kam dhembje
Me ndjenja të dërrmuara eci rrugëve
Kudo që shkoj dhe takoj një varr
Parasysh më paraqitesh ti
Qyteti i varreve o Tivar

11.

Kudo që të jem në këtë moshë të shtyrë
Ti nuk je asnjëherë larg meje
Pak vite pas lindjes sime
U ngjizëm me një dhembje të përbashkët
Unë u rrita në një varr
E ti rrethuar me varre në Tivar

Atdheu im i djegur në zjarr
Nëpër çdo skutë
Mbjellë kanë nga një varr
Si t'i shëroj këto plagë të hapura
Si t'i mbylli kujtimet e plagëve
S'jam në varr e as në Tivar

Një ditë mora udhë të gjatë
Ika nga prehri yt
Por kudo që më shkeli këmba nga pak
Ti përherë dhe kudo ishe hija ime
Atdheu im i kallur flakë

Nuk më lënë rehat as në mërgim
I dërguan veladonët e zinj
Në shtatë palë qiell i përzien yjet
Të gjitha dritat m'i patën shqim
Por ty përherë atdhe të mbaja në gji

12.

Të përgjërohem varri im
Më beso
Unë i ndiej thellë në shpirt
Klithmat e tua apokaliptike
Ndiej përpëlitjen tënde në Tivar

Po digjen do zjarre të mëdha
Po duket një flakë e prushtë në varr
Mbase eshtrat janë çuar peshë
Dhembja me pikëllimin
Përfundimisht një ditë do me u ndesh

Nëse nuk mund të të ofroj asgjë
Merre këtë copë të ashtit të thyer
Vendose diku në ndonjë varr
Merre hisen tënde
Le ta ndiej veten si në Tivar

Prishtinë, 9 prill 2015

13.

Thonë se prilli ishte i gjallë
Por nga gjaku
Asnjë lloj luleje nuk mbiu at vit
Nëpër fushat e dhembjes
Lulëzuan vetëm do lule bozhuri

Nga një pikëllim i pa përshkruar
Harabelat e manaferrave
Si nëpër baladat e lashta ilire
I ngjyen krahët me gjak njeriu
I ngjyen dhe fluturuan hapësirave

Vetëm atë ditë kur i prenë plepat
Nuk u dëgjuan cicërimat e drurëve
Gjethet me sy të përlotura
Në heshtje mortore
Fluturuan nëpër fshatrat e Dukagjinit

Një harabel krahthyer
I këputur nga lodhja e gjatë
U ndalë në prehrin e akullt të një nëne
Duke u shndërruar në peng përjetësie
Lëshoi dy vrizma lotësh të kristaltë

14.

Me vjet të tëra s'pushojnë vajet e zogjve
S'mejnë as nënat syshterur
Nuset na u moshuan
Kurse djemtë që mbetën pa baba
U rrëfejnë fëmijëve të tyre
Një histori të gjallë fantazmagorike

Nuk është ky rrëfim
I pjellë nga mendja e sëmurë e njeriut
Por një e vërtet që ngjau në Tivar
Një natë të vonë
Ose në mëngjes herët
Ku si deti i gjerë u hapë një varr

Por dheu mëmë qëndroi krenar
Nuk i përpiu thirrjet njerëzore
Ende sot dëgjohen britmat e thikave
Nga majat e të cilave
Pikon një lloj amaneti
Një thirrmë të mprehtë lëshojnë rrënjët

15.

Në mendjet e shthurura njerëzore
Veç po duken dhe dëgjohen
Ato këlthitje të lashta
Të një mëngjesi
Por ishin vetëm këlthitje të kota
Sërish i përjetuam netët e thikave

I pamë trenat e çmendur
Dhe i dëgjuam në shpirtrat e zbrazur
Zërat e trishtuara të binarëve
Udhëtimi ishte i gjatë deri te vdekje
Kur mbërrimë në fushën e përlotur
Andej kufirit na priti shiu i vakët i atdheut

Mbi qiellin e mjegulluar
Përjetuam fluturimet e zogjve të shpresës
Si në ëndërr i dëgjuam krakëllimat
Metalike të motorëve
Mbi fushat e mëllenjave
Për herë të parë mbiu një ditë e bardhë

16.

Më duket se nëpër dhiare
Ecëm edhe njëqind vjet
Rruga zgjatej si tërkuzë samari
Shkelëm mbi eshtra
Dhe kafka të ndrydhura

Udhët shndërroheshin në varre
Kurse varret
Në duna të vithisura të kujtesës

Mbase s'do të ndalemi asnjëherë
Do depërtojmë
Do shkojmë edhe përtej diellit
E vetmja rrugë e pashkelur që na ka mbetur
Është ajo udhë e gjatë e lirisë

Në çastin kur mbërrimë
S'do të ecim asnjë hap më tutje
Neve na mjafton kjo tokë e grabitur
Dhe e gllabëruar nga të huajt

Na mjaftojnë dhimbjet tona
Tok me eshtrat dhe varret e mbjella
S'do të shkelim kurrë nëpër ato të huaja
S'do të shkelim asnjëherë se jemi njerëz

17.

Ishte një ditë e thyer e javës
Cilado qoftë ajo ditë
Mbolli në shpirtra urrejtjen
Por kurrë nuk mundi
Me shkulë dashurinë e një nëne për atdhe

Çdo lindje e re përcillej me nga një krismë
Nënat shqiptare bekoheshin me dashuri
Aq ishin të bukura
Sa që u përngjanin zanave
Mbillnin e i rritnin lisat nëpër male

Kështu dukeshin nënat tona
Zana me shtatë flatra
Po u dogj njëra
Edhe shtatë të tjera si nëpër përralla
Mbinin nga shpirtrat e tyre të virgjëra

Nënat tona të bukura
Nënat e mëdha shqiptare
Si njomëzakët në djepin e shpresës
Përkundnin atdheun duke shëruar
Të shtatë plagët e hidhura të Gjergjit

18.

Miku im Përparimi i ngjanë rrapit
Ose lisit të moshuar
Një ditë është si shelgu i pikëlluar
Kurse ditën tjetër i ngjan lotit
Një herë rri pranë djallit
Kurse herën tjetër afër Zotit

Kështu e ka ky njeri i mirë
Sot i përngjanë violinës së thyer
Kurse të nesërmen
Si dashurinë i skalit në dritë
Tingujt e kënduara
Dhe këngët më të bukura për atdheun

Ky burrë i qetë e zemër vullkan
Rrugëve të Tiranës
Parakalon si një kardinal
Në shpirtin e tij bujar valon gjaku Dardan
Rritë e mëkuar me dashurinë e nënës
Skeptrin e mirësisë në zemër e mban

19.

Mbrëmë në ballë të atdheut
Pashë disa pika gjaku
Dhe diku në tepe të kresë
Një fushë e konvertuar në varre

Kjo tokë e bekuar nuk i njeh lotët
Kudo nëpër udhë hi e zjarr
Nga tufanet dot s'pikëllohet
Kurrë s'pati kohë për të qarë

Andaj sot kalon nëpër këta bedena
Ecën kokëlartë dhe po aq krenar
Sa që turpërohen armiqtë atje ku janë
Për plagët e hapura në Tivar

20.

Ecëm dhe nuk u ndalëm
Na priste diku një luftë e madhe
Lisat me qindra gozhda në trup
Merrnin frymë si njerëz të plagosur

Mbi fijet e fishkura të barit
Pamë një kryq prej gjaku
Qante kryqi dëneste deti
Tok me gurët nëpër lagjet e Tivarit

Ne sërish nuk u ndalëm
S'deshëm të matemi me gjatësitë e rrugëve
As t'i numërojmë varret
Atdheu na priste te plepat e bardhë

Ju thashë s'do të ndalemi
Do ecim edhe nëse duhet të dalim fare
Për të mbërri ta përqafojmë atdheun
Na duhen shumë e shumë varre

21.

Çdo ditë thoshte im atë
Përsëriste në çdo kohë
Ndjesë pastë
Përherë pohonte me krenari
Se ne nuk jemi fëmijët e qyqeve

Për të ecur ballëhapur dhe krenarë
Përtej çdo pamundësie
Duhet domosdo të injorohet vdekja
Se përndryshe vetëm të gjallët
Mund të mbërrin në cak

Andaj për t'i tejkaluar
Lumenjtë e çmendur
S'duhet shkelur mbi dërrasa
Që kundërmojnë kalbësirë
Se vetëm kështu
Mund t'i mbërrijmë lisat
Që na presin diku në fund të udhës

22.

Një mijë herë kam thënë
Se s'do të këndoj për Tivarin
Por më falni
Ja që kurrsesi s'munda
Nuk munda aq thjesht ta përpij
Këtë dhembje që pulson mbi barin

Po si mund të harrohen varret
Dhe eshtrat e dhunuar
Ende një kryq prej druri
Mallkon e s'ndalet së mallkuari ditën
Kur na i zhdukën fëmijët
Vetëm korbat e kuq mund ta bënin këtë

O më falni që përsëri
Po ju hap dhembjet dhe plagët
Por ato as që janë të mbyllura
S'do të mbyllen kurrë
Po që se i harrojmë
Ato sërish do të përsëriten
Mbi pafajësinë dhe kokat tona

23.

Në çdo stinë e në çdo behar
Çel një lule në Tivar
Çel një dhembje
Që s’do të ketë shërim
Çfarë të bëjë unë me shpirtin tim

Nëpër grigje del një nënë
Verë e dimër lëshon gjëmë
I lëshon gjëmat tërë vrer
S’ka të shkretës
Kush t’ia hapë atë derë

Çdo mëngjes i shkul flokët e bardha
Zemra gjak gjithmonë i pikon
Herët që menatë e shoh te dardha
Duke dënesur me ngashërim
Ja nis këngës me zogjtë vajton

24.

Ende në fshat dëgjohet
Se si qanë po ajo nënë
Zëri i saj i shemb muret

I shemb muret e rrafshon muranat
Vajit të trishtë
I bashkohen zanat

Qanë e mjera tërë ngashërim
Loti lotin s'mund ta ndalë
Ulet te kopshti dënes me trishtim

Ah sa shumë paska mall
Mbeti e mjera
Pa të vetmin djalë

S'përkundi kurrë nipa në prehër
S'pati mbesa me rritë për nuse
I shkoi jeta vrer e zeher

Për çdo ditë po dënes një nënë
Fishket e shkreta sikur bari
Kur në mendje i del Tivari

25.

Sonte janë rreshtuar të vrarët
Prej të parit
Deri te njeriu i fundit
Me veladon të bardhë
Festojnë fitoren mbi të Kuqët

Ndizni zjarret në Prekaz
Le të marrin frymë flakadanët
Asnjë njeri sonte s'mungon
Nga të katër anët e Kosovës
Të mos pushojnë daullet e fitoreve

Prej kolonadave të mermerta
Një nga një po ringjallen të pushkatuarit
O ju lutem
Merreni pallton dhe këmishën
Po ashtu edhe lëkurën time
Hidhuani mbi shpatulla statujave

Dimrat janë të gjatë në Kosovë
S'lejojmë të ngrihen fëmijët tanë në mermer
Ju thashë
Sonte janë të gjithë gjallë
Mbështillni me dashurinë tuaj
Gjakun që priti mbi gjashtë dekada me radhë

Por vetëm dy gjysma

Cikli i dytë

ÇFARË TË BËJ ME DORËN E DJATHTË

Sonte jam një tërësi e zbrazët
Gjysma ime
Paska mbetur në gjysmën tjetër
Me parathëniet e heshtjeve

Ju lutem mos më prekni
As mos provoni
Sepse s'keni se ku të prekni
Do pëlcas si flluska e sapunit

Dikur isha një tërësi në vetvete
Nuk i duroja gjysmat në jetë
Por tani është krejtësisht ndryshe
Jetoj vetëm me një pjesë të gjysmës sime

Një gjysmë në mua pëshpërit
Për gjysmën tjetër
Asnjëherë më s'do bëhem një tërësi
Si mund t'i bashkoj gjymtyrët e fjalëve

Brenda kësaj lagështie
Mund të jetojnë vetëm gjysmat e kandrave
Çfarë të bëj me dorën e djathtë
Kur e majta ka mbetur jashtë mureve

IA HUAZOVA GJYSMËS SË STERRËS

Atë ditë kur desh më ngufati uria
Pata ngrënë vetëm një gjysmë kafshate
Kurse gjysma tjetër
Mbeti peng
Në sqepin e një korbi të zgërlaqur

Brenda gjysmës së dhomës
Kishte depërtuar vetëm një gjysmë drite
Edhe frymëmarrja e përgjysmuar
Ngushtohej
Ngushtohej deri te gjysma e saj

Atë çast gjumin e ndave në dy pjesë
Njërën e mbajta për vete
Kurse pjesën tjetër
Ndoshta më me shumë vlerë
Ia huazova gjysmës së sterrës

Më duket se sonte çdo gjë
Qenka përgjysmuar
Në këtë gjysmë qetësie
Jeton gjysma tjetër
E një zhurme të përgjysmuar

POR VETËM DY GJYSMA

Më thanë se vetëm dy gjysma
Bëjnë një tërësi
Po ku mbeti gjysma tjetër
E qenies sime e cila nuk ekziston

Ku ta gjej tërësinë tjetër
Të mollës së kafshuar në degët e gështenjës
Poçari më tha se shtamba e thyer
I ka më shumë se dy gjysma

Një gjysmë ere asnjëherë
Nuk mund të shndërrohet në furtunë
Gjithmonë në jetë na duhen dy gjysma
Për ta formuar gjysmën tjetër imagjinare

Me gjysmën e buzëve
Edhe puthjet janë të përgjysmuara
Por edhe dy gjysma
Asnjëherë nuk bëjnë një tërësi

Ngjan që ndonjëherë të jem
Vetëm një pjesë e gjysmës sime
Kurse herën tjetër gjysma e jote
Por asnjëherë nuk isha një tërësi e përsosur

ISHTE AJO GJYSMA TJETËR

Në gjysmën e zërit tim
Ishte ajo gjysma tjetër
E zërit tënd
Por tejet e zëshme si përherë

T'u afrova me gjysmën e parë
Të dashurisë sime
Po ashtu edhe ti ma ktheve
Me gjysmën tjetër të dashurisë tënde

Aq shumë ishim të fragmentuar
Sa që pjesët më të bukura të asaj dite
I harruam përgjithmonë
Nën degët e gështenjës së përgjysmuar

KURSE TI I DOJE VETËM TËRËSITË

Kur isha një tërësi e plotë
Gjysma jote notonte në hapësirë
Duart e tua të mishta
Llamburitnin në detin e vdekur
Si dy lopata të verbëta

Të pata thënë se unë jam adhurues
I gjërave gjysmake
Kurse ti i doje vetëm tërësitë
Që s'mund të ndahen
Në dy pjesë të barabarta

Sonte bëra një gjysmë gjumi
Fjeta vetëm me njërin sy
Syrin tjetër të kaltër
E vendosa në gotën e kristaltë
Të dalloj më qartë
Gjysmën tjetër të mbrëmjes

Protezën e sipërme të dhëmbëve
E harrova mbi tavolinë
Kurse me të poshtmen e thyer
Nuk më zuri gjumi
Andaj bëra një sy gjumë lepuri

Prishtinë,10 prill 2015

KËTO ÇASTE TË PËRGJYSMUARA

Vonë kuptova se në këto çaste
Jam copëtuar në qindra pjesë të gjysmave
Një njeri mes fragmenteve të thyera
Asnjë gjysmë prej meje
Nuk paska mbetur në pasqyrë

Për befasinë e të gjithëve
Vetëm ai person përtej imazheve
Duket si një tërësi e pandashme
Edhe buzëqeshjet i ka të tilla
Të pa fragmentuara

Shikon në thellësinë e shpirtit tim
Me një kovë të zezë teneqeje
I nxjerr pjesët e gjysmave
Era llamburit në dhomën e acartë
Muret dëgjojnë disa arie muzikore

Jetoj mes këtyre çasteve të përgjysmuara
Nga sytë e mi si lotët e përgjysmuara
Lëvaren degët e plepit të bardhë
Nëpër çerdhet e rrënuara disa zogj të imtë
Harruan një grumbull vezësh me pikla

NUK E KA TËRËSINË E SAJ

Me një gjysmë ëndrre të shthurur
Pa gjysmën tjetër të saj
Njeriu nuk i përngjan asnjë ëndrre
Përpos një makthi të fragmentuar

Një ditë jam vetëm një gjysmë ëndrre
Kurse ditën tjetër
Më paraqiten zhgjëndrrat e përziera
Me makthet e të gjitha ngjyrave

Asnjë gjymtyrë në qenien time
Nuk e ka tërësinë e saj
Kur më mungon unaza në dorën e djathtë
Tek unë ushtojnë kambanat e së keqes

Gjërat e përgjysmuara nëpër dhomë
Janë vetëm pjesët e një gjysme
Kurse njeriu i tillë gjysmak
Që në fillim është i dënuar për dështim

Gjysmë fjale pa asnjë germë
Po qe se i mungon frymëmarrja
Është vetëm një zbrazëti e trishtuar
Që askund nuk i shihet fundi

E VERDHA ISHTE PËRZIER ME TË KUQEN

Sot në lagjen time takova
Dy njerëz duke ecur rrugës tërmal
Ecnin me gjymtyrët e tyre të përgjysmuara
Kjo pamje i ngjante pantomimës

Në shikim të parë dukeshin
Si portrete surrealiste të varur në mur
Nga flokët e tyre të thinjura pikonin
Gjysmat e pandashme të të gjitha ngjyrave

E verdha ishte përzier me të kuqen
Kurse e kuqja gjysmën e saj
E kishte huazuar nga ajo e zeza
Kështu ky bashkim gjysmak ishte pa kolorit

Ju thashë se për një tërësi ngjyrash
S'duhet të mungoj asnjë gjysmë
Në të kundërtën si do të dukej ylberi
Kur shfaqet me imazhe të përgjysmuara

MERRE GJYSMËN TËNDE TË HUMBUR

Me vetveten tënde të paplotësuar
Ti je vetëm një gjysmënjeri
Ajo gjysma tjetër
Mund të jetë vetëm makthi yt

Vështroje me kujdes itinerarin
Nëse nuk mbërrin atje për ku je nisur
Gjyma jote ka mbetur pas teje
Si një imazh i papërfunduar

Mati mirë hapat e tua
Mate me kujdes kujtesën tënde të brishtë
Jeta e ndarë në disa fragmente
Kurrë nuk do të mund të arrijë qëllimin

Me ëndrrat e tua të ndara në shumë pjesë
Ti që në fillim veç je i fragmentuar
Merre gjysmën tënde të humbur
Dhe bashkoje me gjysmën tjetër të gjetur

MË MIRË NJË GJYSMË ËNDRRE

Pa gjysmën tjetër të një tërësie
Njeriu nuk mund të jetë
Ajo pjesa e përkryer
E imagjinatës së një ëndrre

Ne të gjithë jemi të gjykuar
Të jetojmë mes ëndrrave
Vetëm me një gjysmë vegimi
Kurse gjysma tjetër i takon futurizmit

Prapëseprapë
Mua më mjafton në këto çaste
Vetëm gjysma e ëndrrës sime
Kurse gjysmën tjetër e gjej pas vdekjes

E dua dhe s'mund të jetoj
Pa gjysmën time të shëndoshë
Kurse ajo tjetra
Domosdo është e gjykuar të zhduket

Më mirë një gjysmë ëndrre
Se sa dy ëndrra të boshatisura
Kështu plotësohet
Tërësia më e madhe e qenies njerëzore

PO QE SE BASHKOHEN TË DY GJYSMAT

Sonte dua të loz vetëm me hijen time
Të lozim valsin e shiut që e filluam atë natë
Le të mos ndalen daullet
Kjo kitarë e vjetër
Paska dy lloje tingujsh

Do isha tepër i mrekulluar
Sikur të vdiste një pjesë e gjysmës sime
Kurse pjesa tjetër
Ajo shpirtërore
Të jetonte me tingujt e kësaj muzike

Kështu që prej dy gjysmave
Njëra merr frymë si bari i gjelbër
Kurse tjetra që ia tejkalon simfonisë së pestë
Le ta përfundojë misionin
Si flutura e djegur

Po qe se bashkohen të dy gjysmat
Në një gjysmë rrethi magjik të unazës
Do lindte një tjetër njeri
Në këtë univers
Me përsosmërinë e tij prej tingulli e mishi

TAKOJ NJERËZ ME SY TË VITHISUR

Nëpër tavernat e vjetra të qytetit
Takoj njerëz me sy të vithisur
Të fundosur nëpër fundet e pafundme
Të gotave të mbushura
Dhe të atyre gjysmë të zbrazëta

Njëri përshëndetet me vetveten
Kurse tjetri nga një fund i padukshëm
U bën me dorë hijeve
Të ulura nëpër skutat e kafeneve
Duke rrufitur fillimin e një gjysme

Nga xhepat e shqyera
Një nga një po u bien shiringat
Shëtisin shëtitoreve të zbrazëta
Të mendjes
Me stomak të zbrazur e kokë të dehur

Pa asnjë shpresë për të nesërmen
Bredhin nëpër lagjet e skamnorëve
Se vetëm prej tyre mund të këpusin
Ndonjë lek të mykur
Për ta mbushur një gjysmë gote të dehur

Ndonjëherë bashkëvendësit e mi
Dalin dhiareve të fëmijërisë
Dhe me tërë afshin e jetës i kërkojnë
Po ato imazhe
Të përgjysmuara prej mjegullave
Që kurrë nuk arritën t'i zënë

E TËRË FUSHA E MËLLENJAVE

Si krah fluturash nëpër stiva shoh
Dengje drurësh të djegur
Mjegullat u pështillen nëpër këmbët e drunjta
Korridoret e errësuara nga eklipsi
Kanë filluar të lëshojnë një dritë të verdhë

Nën pemishtet e thara
Tani më nuk rritet asnjë lule
E tërë fusha e mëllenjave
Po i shkul bozhuret e sëmura
Një diell i ri posa lind në tokën tonë

Pak më ndryshe sot po marr frymë
E pakëz më shumë
Po më ngacmon kjo kollë e keqe
Arat paskan mbetur peng i thatësirës
Kush do t'i lërojë këto lëndina të harruara

Kalorësit e vetëtimave
Mbrëmë ishin mysafir në tokën tonë
Prej patkonjve të kuajve të paçjerrë
Farkëtarët e moshuar
I farkuan të gjitha llojet e patërshanave

NËPËR RAFTET E PLUHUROSUR

Posa e hodha hapin e parë
Hasa në dhomën time të fjetjes
Me qindra autostrada kërmijsh
Tjegullat nën ethe
Përjetojnë kataklizmin shpirtëror

Nëpër raftet e pluhurosur
Nuk shoh asnjë libër të vjetër
Mbase i paska ngrënë dhëmbi i kohës
Nga të çarat e dërrasave të tavanit
Shiu po pështyn të gjitha sëmundjet

Prej gazetave të vjetra disa dekadash
Shpendët paskan ngrehur çerdhe të përsosura
Ose nëpër foletë e zogjve shtegtarë
Paskan zënë vend minjtë
Dhe llojet e kandrave ekzistuese

Këndi im i preferuar ku në netët e gjata
Shkruaja poezi për adoleshentët
Qenka shndërruar në çerdhe egërsirash
Nuk mungojnë as zërat e trishtë
Të hardhucave dhe të gjarpinjve helmues

THOSHTE SE KA VETËM NJË ATDHE

Shikonte majat e shelgjishteve të bardha
Ndoshta donte të konvertohej në pëllumb
Nga ana tjetër
Nuk i përngjante asnjë shpendi
Por pa masë e donte artin e fluturimit

Thoshte se ka vetëm një atdhe
Dhe me mallëngjim të paparë
I përcillte dyndjet e reve
Sytë i drejtonte kah mjegullat e plumbta
Për së tepërmi e donte shiun

Kishte një pamje njerëzore
Kur qeshte zëri i tij tingëllues
Gurgullonte si lumi
Nëpër shëtitoret dhe rruginat e gjera
Si të dashurën i përqafonte drurët

Sa herë që zgjohet në mëngjes
Bisedonte me tingujt e kitarës së thyer
Ua fshinte lotët e telave të këputur
Sepse për së tepërmi frikësohej
Të mos ndryshken notat në pentagram

PO NËN ATË PEMË

Po të them se sonte
Nuk ka vdekje në fushën e kujtesës
Përse të vdesim
Pasi që nuk ekziston mortja
Tani na presin trëndafilat në kopsht

Nëse ke kohë
Eja me tërë forcën e dashurisë
Të kujtohet
Kur i përjetuam pranverën e kaluar
Tërmetet e gjetheve

E di se ty të mbulonte një turp
Tepër i frikësuar shikoje qiellin
Fustani yt i all
I përngjante beharit të qershive
Kurse ti i ngjaje përsosmërisë

Eja sa herë që do mund të më gjesh
Po nën atë pemë
Duke biseduar me gjelbërimin
Kurse gjethet po t'i lë ty
Të fundosesh
Në shpirtin e pafund të kësaj nate

SYTË E PËRGJUMUR TË AGULLIMËS

Këto çaste të pakapshme
Vetëm njëherë në jetë
Mund të përngjajnë me ushejzat
Të cilat në pranverën e hershme
Rrëshqasin si ngjalat
Nëpër shpirtin e kaltër të Lumëbardhit

Rrëshqasin për të mbërritur sa më shpejtë
Në përqafimin e etshëm të Jonit
Dje ishte një rrugë tepër e gjatë
Kurse sot i shtrimë duart tej maleve
Dhe sa ora i freskuam shikimet
Në ëndrrën e përgjumur të agullimës

I TËRË VATHI DIMËRON

Në vjeshtë këtu mbyllen të gjitha dyert
As lehjet e qenve s'dëgjohen
Blegërimat zbresin në fshat
I tërë vathi dimëron
Nën aromën e pjekur të gështenjave

Barinjtë dhe bareshat
Me padurim presin syrin e pranverës
Vetëm le ta çelë gojën gjethi i parë
I tërë fshati tok me vakërrimat
I bashkohet vathnajës

Mbi tapetin e gjelbërimit
Si psalmet nëpër kisha
Dëgjohet zëri melankolik i fyellit
Çohet peshë lugu i zanave
Bari i njomë i ledhaton pemët

S'ndalen as blegërimat e qengjave
Uji i akullt i gurrës
Ngrin lotin nën qerpik
Bareshat me nga dy furka nën sqetull
I thurin çorape vjeshtës

PARA SE TË SHKUNDEN GËSHTENJAT

Kur janë të lumtur drurët
Orë e çast dëgjohen
Cicërimat e gëzuara të zogjve
Nën degët e harlisura të rrapeve
Dëgjohen monopateve
Bulurimat e pandërprera të stinës

Pranvera dhe vjeshta
Pa përtesë i pjekin frytet
Para se të shkunden gështenjat
Nën këmishët e mëndafshta
Të vashave lozonjare
Mollët e kuqe gufojnë si gjelbërimi

Djelmoshat e fshatit për çdo mëngjes herët
Në qafën e hollë të hënës
I numërojnë rruzaret e argjendta
Qielli i përskuqur i mëkon yjet
Nga frytet e pjekura të pemëve vjeshtake
Si nëpër balada zbresin dasmorët e një stine

KËTO SHKURRE TË ATDHEUT TIM

Asgjë nuk më duhet në këto çaste
Më mjaftojnë vetëm duart e tua
Dhe aroma e gjelbërimit
Ky lumë me gjasë
Sonte po buron nga shpirti i një peme

Të thashë nuk më duhet asgjë tani
Afromi duart e tua të mishta
Dua ta prek në shpirt gjelbërimin
Kurse këto shkurre të atdheut tim
Po më duken si kopshtet e parajsës

Mbrëmë ishte një dimër i pështirë
Në qytetin tonë
Me mallëngjim dënesnin kallkanët nëpër çati
Sot qenka krejtësisht ndryshe
Nga katër anët e qytetit buzëqesh pranvera

ME TELAT E TENDOSUR TË KITARËS

Tani më ka zbritur vjeshta
Këto pantallona të zhubravitura
Po ua lë amanet pemëve
Dhe gjarprit të shtëpisë
Më duhet ta hekuros lëkurën e grisur

Nëpër çdo skutë të qytetit
Dëgjohen ulërimat e ujqërve
Fqinjët janë mbyllur përbrenda portave
Dhe në heshtje tërë frikë
Dëgjojnë frymëmarrjen e së keqes

As njerëzit nuk shëtisin rrugëve
Vetëm qentë endacakë
S'i ndalin të lehurat
Dëgjohen edhe lehjet e natës
Sonte nga këto lëvizje të pakontrolluara
Mund të ndodh ndonjë tërmet brenda meje

Ka kohë që s'jam ndier kështu
Muskujt e duarve ngjajnë
Me telat e tendosur të kitarës
Vetëm një thirrje e vockël më duhet
Të bashkohem me vetëtimat e maleve tona

MEGJITHATË KËTO VRIZMA SHIU

Si statujë qëndronte në prag të derës
Me të dy gishtat tregues
Në tëmtha
Shikonte me nostalgji
Kah rrënohej oxhaku shekullor

Nga kjo pamje e trishtë
Ndiente rrëqethjen
E pemëve të ngrira në kopsht
Me bastun në dorën e majtë
Mundohej t'i fshinte djersët e ballit

Po bien nga pak disa vrizma
Alegorike shiu
Prej thinjave të flokëve të këputur
Një avull i vakët
Po i del prej tepes së kresë

S'ndalet së rrënuari oxhaku
Plaku ofshan si Drini i Bardhë
Ofshajnë drurët dhe pemët në kopsht
Megjithatë këto vrizma të zjarrta prej shiu
S'paskan të ndalur sonte

Prishtinë,11 prill 2015

SËRISH NJË HIJE E LËNGËT

Një hije e lëngët
Më duket se as nuk hyn
As nuk del prej ujit
Nga ky këndvështrimi asnjanës
I ngjan pasqyrës së thyer në mur

Ca tufa të zeza zogjsh
Në shuplakat e erës e shuajnë etjen
E pikëllimit të zjarrit
Nën shelgjet e pikëlluara
S'pushon kori trishtuar i ditës

Kjo natë nuk i përngjan asnjë nate
Nuk është si netët e tjera
Nga sytë e saj të verbët
Pikon një sterrë e trishtuar
Përfundimisht era i kafshon mollët në kopsht

Sërish një hije e lëngët
Si gjarpri në një vrimë të verbët
Depërtoi deri te rrënjët
Për herë të parë filluan gjethet
Të lulëzojnë dhe të frymojnë si njeriu

DËGJOJ VETËM ZËZËLLIMA ZËRASH

I gjithë qyteti ka rënë në heshtje
Drurët ecin si në procesion
Sa afër vdekja e sa larg varret
Kush po fërshëllen
Melodinë e preferuar të erës

Në këtë heshtje mortore
Si zëzëllimë bletësh
Dëgjohet vrizma e pandërprerë e shiut
Këndesat e metaltë mbi çati
Përvajshëm e zgjojnë mëngjesin

Të heshtur qëndrojnë sokakët
Askush nuk di
Se ku po fshihen qentë
Nëpër hambarët e boshatisur
Minjtë lozin një valle të lashtë pagane

I prek duart e rrudhosura të kopshtit
Ndiej ngrohtësinë e degëve të thyera
Sa shumë zjarrmi paska kjo heshtje
Në shpirtrat e këputur të rrënjëve
Dëgjoj vetëm zëzëllima zërash prej gjetheve

ÇFARË PO NDODH ME SHTREZET E NGRIRA

Fjalët lakuriqe si kërmijtë
Ngjiten nëpër lagështit e mureve
Brenda në dhomën e gjumit
Dy gazeta të vjetra i shkundin germat

Si me gishtat e padukshëm të fantazmës
Degët e ftonjve trokasin në dritare
Në dhomë dhe jashtë saj asnjë njeri
Kurse të trokiturat s'dinë të ndalen

Kush po troket kaq vonë në kokën time
Unë mungoj sot në këtë heshtje
Nuk isha as dje këtu
Me qindra vite udhëtova nëpër mendjen time

Kurrsesi të mejnë zërat e lagësht
Të këtyre mureve të akullt
Po më ngrihen thonjtë në këtë vetmi
Ju lutem mbulomëni thinjat e flokëve

Asnjë zë njeriu nga jashtë
E as nga brenda
Çfarë po ndodh me shtrezet e ngrira
Sërish degët e ftonjve s'i ndalin të trokiturat

TURTUJT DALIN MALEVE

Kur vjen dimri i acartë
Nga sytë e njerëzve arratisen
Stinët e tjera
Turtujt dalin maleve
Diku në përgjumjen e rrapeve
Presin të kthehen zogjtë shtegtarë

Arinjtë nëpër sterra e shpella
I kërkojnë dromcat e dashurisë
Ngjan që zgjohen herët
Nga krakëllimat e korbave
Ose zërat e trishtuar të kukuvajkave
Depërtojnë në gjumin e thellë të gurit

Por gjithsesi gjërat nuk rrjedhin
Përherë në atë rrafsh
Siç janë lindur
Kur zgjohen ulërimat e ujqërve
Zgjohen dhe u ngjajnë instinkteve
Në palcën e tokës kafshojnë gurin e ngrirë

LISAT JANË AQ TË MENÇUR

Çfarë janë këto fytyra pyjesh
Të drunjta
Anemike pa gjak e mish
Por gjithsesi
Frymojnë si njerëzit
Në ecje e sipër nëpër monopate

Dimrat e acartë shumë pak ndryshojnë
Nga stinët e ngrohta të verës
Askush nuk ua prish qejfin
Si me gishtat e hollë të vashave
Furtunat e zeza
Lozin me flokët e drurëve

Edhe këto male të mira
E të larta
Herë u ngjajnë njerëzve
E herë arinjve polar
Kur hidhërohen arratisen te qiejt

Lisat janë aq të mençur
Saqë kur i imitojnë onomatopetë
E tufave nëpër kullosa
Që nga larg dëgjohen si në vathë
Vakërrimat e deleve të qiellit

I PREKIN ZOGJTË NË FLUTURIM

Çunat e lagjes si gjithmonë
Vizatojnë flutura të kaltra nëpër mure
E disa të tjerë mbarojnë
Zogj të kristaltë
Dhe avion ëndërrues prej letre

Herë fluturojnë qiejve
E herë vrapojnë deri te shpirti
I pavdekshëm i luadhit
Për t'u fundosur përfundimisht
Në ëndrrën e përkryer të gjelbërimit

Me gishtat e tyre të hollë prej fëmije
I prekin zogjtë e kaltër në fluturim
Dhe në hapësirën e tendosur të qiellit
Vizatojnë një diell gjigand
Dhe imazhin e dashuruar të atdheut

NGA PUSET E AKULLTA TË REVE

Mbi tavolinën e punës
Një shtambë e vjetër prej argjile
Dhe një gllënjkë e ftohtë uji
Nga puset e akullta të reve

Dielli i mrrolur
Kalëronte mbi mjegullat e dendura
Vetëm hingëllima vetëtimash
Dëgjohen te portat e jashtme të kalasë

Dy zogj të bardhë
Prej deltine
Fluturojnë sheshazi
Mbi qiellin e ngrirë të kujtesës

Asnjë gjallesë tjetër nuk duket
Në hapësirën blu
Nga kjo lagështi e dhomës
Po më bien flokët e zbardhura

Përjashta një dimër i rreptë
Po ashtu edhe përbrenda
Kallkanët po u bien zileve
Sa larg po më duket pranvera sivjet

NË PASQYRËN PËRBRENDA MEJE

Nga pasqyra e paradhomës
Çdo mëngjes dëgjoj
Disa lloje zërash të shthurur
Prapa meje
Era i kreh flokët e saj kaçurrelë

Jashtë në oborr bën vapë
Jo si ditëve të tjera
Por një vapë që ta zë frymën
S'marrin frymë as drurët e njomë
Dielli i azdisur para kohe po i pjek ftonjtë

Kam një mëdyshje të madhe
Të qëndroj në dhomë po më ngrihet gjaku
Të dalë jashtë kësaj paradhome
Dielli po m'i pjek trutë
Çfarë të bëj me pasqyrën në mur

Shikoj në oborr tej dritares i shoh pemët
Të rënë në dy gjunjë
Në pasqyrën përbrenda meje
Si në ndonjë ëndërr të ëndërruar me herët
Hapësirave blu fluturojnë dy zogj të kaltër

Vizatuam një bukë në mur

Cikli i tretë

NGJANTE QË NË NETËT E FESTAVE

Nuk di për shpirtin e kujt
Janë ndezur gjithë këta qirinj
Kjo blozë nëpër korridoret e kujtesës
Kurrsesi të shkundet
Nga këto të brusha të çelikta

Netët këtu zgjasin me vite
Dimrave flenë në prehrin e heshtjes
Për vdekjet e njerëzve
I ndiznim qirinjtë e shpresës
Kurse bloza e zezë e trashte lëkurën

Ngjan që në netët e festave
Të ndezim nga dy ose më shumë qirinj
Kështu bënte im gjysh
Se kinse me ndezjen e qirinjve
Secili shpirt domosdo përjeton ringjalljen

DOLI NË BEJLEG SHPENDI DYKRENOR

Zor e kam t'ju them
Por atë ditë atdheu im
Nuk i ngjante dot atdheut
Nga ashti i tij shekullor
Kullonte një gjak i zi në të murrmë

Në ato çaste të pashpresë
S'kishte asnjë flamur në dorë
Po ashtu edhe në kokën e dërrmuar
I mungonin fashat e plagëve
S'kisha me çfarë lecke t'ia fshija lotët
Atdheu im vuante mes kudhrës dhe çekanit

Nuk di se ku i kishte fshehur
Flamujt e luftës
Por gjithsesi në ndonjë vend të sigurt
Atdheu ishte buka jonë e përditshme
Ishte edhe kripa në plagën e hapur

Nga kurmi i tij gjysmë i gjallë
Dhe gjysmë i vdekur
Si nga ndonjë legjendë apokaliptike
Doli në bejleg shpendi dykrenor
Dhe iu bashkua zogjve të shenjtë të lirisë

FSHIHEJ VDEKJA E PASHPJEGUESHME

Ishte një kohë krejtësisht ndryshe
Nëpër rrugicat e ngushta
S'dëgjoheshin më lehjet e qenve
Kishin heshtur edhe këndesat
Një kokë njeriu vlente
Sa një kokërr e kalbur misri

Një çerdhe e zezë mitralozi
Villte plumba nga minarja e xhamisë
Përskuqeshin kulmet me rrasa
Dhe ato të mbuluara me myshqe
Afër oxhakëve të shembur
Fshihej vdekja tinëzare

Nëpër lagjet më të thella të qytetit
Kalonin njerëz as të gjallë
E as të vdekur
As hijet e mykura
Nuk u përngjanin më hijeve
Dukeshin si disa krijesa të shëmtuara

Mbi kokat tona asgjë s’dallohej
Vetëm pantomima e vdekjes
E njihte fare mirë
Trishtimin e alfabetit mors
Nga minarja e xhamisë
Shi plumbash derdheshin
Mbi kokat e pambrojtura të njerëzve

NËN ÇATITË E RRËNUARA ÇIFTËZOHET STERRA

Në këtë lagje duart e njerëzve
Ngjajnë me shelgjet e pikëlluara
Sa herë që paraqiten shirat
I dëgjojmë vakërrimat e heshtura të rrënjëve

Mbrëmjeve vonë kur e tërë bota pushon
Pemët dalin rrugëve të qytetit
Dalin dhe i përshëndesin kalimtarët e vonuar
Që kthehen në shtëpi me pak vrizma shiu

Kur i tërë qyteti bie në gjumë
Pa dalë në dritë agullima
Dëgjohen vetëm mjaullimat
Nën çatitë e rrënuara çiftëzohet sterra

Prishtinë, 12 prill 2015

KY SORRAK I SOJIT TË SORRAKËVE

Kur pi kafenë e mëngjesit
Përpos ankimit të përditshëm
Nën qerpikët e urrejtjes
I fsheh të gjitha krimet
Si violinisti virtuoz
Shfajësohet nga të bëmat e tjera

Ai duket aq i virgjër
Saqë i dhimbset çdokujt
Kurse në anën tjetër
Nën gjuhën e pistë të vrastarit
E fsheh thikën e mbytur në gjak

Njeri me disa fytyra alegorike
Pas një maske prej plastike dhe mishit
I fsheh të gjitha të ligat e dynjasë
Në vend të dritës
Errësirën e mban në shpirt
Ky sorrak i sojit të sorrakëve

NË QINDRA FREGMENTE FRIKE

Një natë e mjegullt sterrë
Vrizma dritash të imta pikojnë
Mbi asfaltin e lagur me trishtim
Shiu i metaltë po i thyen xhamat
Asnjë mjaullimë maceje
S'dëgjohet në këto çaste

Paskan pushuar edhe të lehurat
Kjo qetësi e llahtarshme
Po i gërryen damarët e drurëve
Zë njeriu s'dëgjohet në errësirë
Vetëm zëzëllima e heshtjes
Po e thyen qetësinë e mortjes

Sërish po i njëjti shi metalik
Derdhet mbi xhamat e thyer
Sonte çdo gjë duket e copëzuar
Në qindra fragmente metaforike
Përpos të lehurave të pandërprera
Dhe mjaullimave
Dëgjohen uturimat e aeroplanëve

VIZATUAM NJË BUKË TË MADHE NË MUR

Asgjë nuk mund të blejmë sot
Në korridorin e errët
S'dallohet dyshemeja nga kandrat
Për ta mashtruar urinë
Pa dashje vizatuam
Një bukë të madhe në mur

Jashtë në rrugë uturimë ingranazhesh
Fytyrat e zverdhura të drurëve
Me javë të tëra s'i ndryshojnë pamjet
Sot duken edhe më të zverdhura
Si përherë përngjajnë
Me kurmin e kalbur të pemëve

Nuk ra shi as për një gllënjkë
Etja ishte aq e madhe
Sa që s'mund ta shuante asnjë det
Shiu i zjarrtë dhe i përskuqur
Që pat rënë ato ditë
I dogji trarët e çative të rrafshuara

Mjegullat prej hiri mbuluan qytetin
Atë ditë Prishtina dukej
Si një nuse e vdekur
Në barkun e së cilës qante një fëmijë
Kurmi i saj përpëlitej si pa kokë
Në lagjen Kodra e Trimave
Mallëngjyeshëm jehonte zëri i një fyelli

TË JEN PAKË MË NDRYSHE SE NE

Disa gjëra që nuk i dimë sot
Dhe i mësojmë nesër
Ndoshta na mbajnë gjallë
Për një tjetër nesër
I ngjajmë devesë së etur
E cila e shuan etjen me rërë

Edhe kjo luftë ishte e tillë
Ne gati njëqind vjet luftuam
Luftuam për një të nesërme
Që fëmijët tanë
Të mos na përngjajnë
Të jen pakë më ndryshe se ne

Të mos tremben
Nga të trokiturat nëpër dyer
Mos të frikësohen që fluturimet e zogjve
T'i imagjinojnë si fluturime aeroplanësh
Por të kenë një jetë normale
Siç e ka tërë njerëzimi i botës

FJALA

Vonë kuptova se fjalët
Nuk kanë eshtra
Por eshtra thyejnë
S'kanë as plumba por vrasin
Më keq se çdo plumb

Posa lirohen nga dhëmbët
Të kafshojnë më trishtueshëm
Së çdo kafshim i tërbuar
E tillë është edhe lufta
Vrau drurë e shfarosën njerëz

S’KA MË SHTËPI NË KËMBË

Mbrëmë i pamë ca trajta plumbash
Që i bluanin gurët
Tejpërtej i shponin drurët
S’ka më shtëpi në këmbë
Mbi lumenjtë e dhunuar
Po i shembin urat e metalta

Mos i zgjatni duart përtej dendësisë
Së ajrit të mjegulltë
Atje po reshin shirat prej plumbave
Sonte kurrsesi s’pushojnë
As shrapnelat duke i rrahur muret
Druaj se s’do kemi vend
Ku ta fshehim kokën

Maleve veç po u del flaka
Urithët nën dhe
Po e përjetojnë kataklizmën
Nëpër degë të pemëve kudo shoh
Gjethe të zhveshura deri në asht
Një zonjë e rëndë po i kreh flokët në erë

Edhe sot po të njëjtat trajta fërshëllejnë
Mbi kokat e pambrojtura të njerëzve
Flaka po e lëpin kupën e qiellit
Shirat e metaltë kurrsesi s'mejnë
Jeta si një tramak i ngrirë
Shikon vdekjen në sy

ASNJË PLUMB NË BOTË

Shikoje në pasqyre atë njeri
Se sa mizorisht e urren vetveten
Mbase ende i ka plumbat në kokë

Kur dashuria e mund plumbin
Njeriu gjithmonë është
Një pëllëmbë dore para vetvetes

Më ndje miku im po të them troç
Asnjë plumb në botë
Nuk është në gjendje me e vra lirinë

NUK KA IKJE NGA KJO TOKË E PËRGJAKUR

Sivjet nuk kaluan këndej trenat
Stacioni ishte fundosur
Tmerrësisht në heshtjen e tij
Sa që nuk i dëgjonte
As fërshëllimat e egra të binarëve

Në një hapësirë të vogël
Si kjo e kësaj ndërtese të shurdhët
Përherë do të jetë pengu sovran tek unë
Sovran i një nate të përvajshme
Kur sorrakët i dëbuan zogjtë

Si pyka dhembjesh më mbetën në kokë
Fjalët e një plaku
Kur tha me një vendosmëri të pashoqe
Nuk ka ikje nga kjo tokë e përgjakur
Që nesër do të kthehemi me trenin tjetër

MË MBAJ PËR DORE O VËLLA

Mbi anijet e mendimeve të shthurura
Rrahin velat e deteve
Nga atdheu në Bllacë
Sa qenka larg atdheu im tjetër
I mbërthyer për kudhër
Me dhembjen e nëntë plagëve

Si mund t'i kalojmë malet e Sharrit
Të takohemi me lisat
Që nuk i dorëzohen asnjë furtune
Më mbaj për dore o vëlla
Se mua në këto çaste tragjike
S'po më mbajnë më këmbët

Edhe këto riga shirash po më depërtojnë
Si plumbat në kokë
Më mbaj për dore o vëlla
Më mbaj të lutem
Do të çmendem si atdheu i robëruar
Më mbaj për krahu o vëlla
Se sonte çmendet burri dhe guri

POR NE KEMI NEVOJË PËR PUSHKË O VËLLEZËR

Nuk patëm bukë
Na i shtruat sofrat më të begatshme në jetë
Në vend të jorganit
Na mbuluat me dashurinë tuaj
Dhe të fiseve të gjakut të Pollogut
Por ne patëm
Dhe kemi nevojë për pushkë o vëllezër

Pushka për ta nderuar atdheun
E çnderuar deri në palcë
Për të ua dhënë hakun cerberëve
Si kopenë na lidhën për binarët e trenit
Fërshëllima e egër
Me ingranazhet e saja na i shkelte trutë

Njëqind vjet udhëtuam deri këtu
Uturima e trenit të zi
I përngjante gjëmës
Gjëmonte si Drini plak
Ju na i shtruat sofrat e nderit
Dhe të burrërisë
Por ne patëm nevojë
Për pushkë o vëllezër të mirë

BESOJ SE NUK MBANI HIDHËRIM

Kaluan ditët javët edhe vitet
Por neve na ka kapërthyer një brengë
Po na djeg e përvëlon një mall
Nuk di a patëm çfarë me ju dhënë
Nga frika vizatuam ëndrrën në mur

Armiku na morri çdo gjë që patëm
I vodhi pulat nëpër kotece
Bukën e gojës e grabiti nga çerepi
Egërsisht e pshurri
Miellin e fundit në magje

Kur s'patëm për fëmijët që vdisnin urie
S'mund t'ju jepnim as juve
Të dashur ushtarë
Të vetmen kafshatë që na mbeti
E përtypëm dhe ia dhamë një vogëlushi
Armiku i pat shkulur gjinjtë e nënës së tij

Besoj se nuk mbani hidhërim
Për skamjen tonë
Ishim në gjendje t'jua jepnim frymën
Edhe ju e dini se për luanët e lirisë
Ne nuk e kursyem
As gjakun e fëmijëve të fëmijëve tanë

Prishtinë, 13 prill 2015

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime, kryesisht me poezi, filloi të merret që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe në Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, i pranishëm në disa antologji dhe në librin "Kosova Letrare" të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *"Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990",* nga Hasan Hasani, në *"Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872-1995"* nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin *"Portrete Shkrimtarësh"* nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit e nderoi me çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1. “Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. “Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi
letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. “Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.
15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2o1o.

16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o. “Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010

32. “Zgjimi i gjëmës”,Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. “Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. “ Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. “ Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. “ Përtej teje”,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg” , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12

48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012

64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013
79 “Fërfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013

80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot,2013
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014-
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot ,2014
91.”Krakëllimat e natës”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2014

96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë**”, Poezi, Shoqata e** Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. ” Stina asnjanëse” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
102. “ Një grusht dashuri” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim” , poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
105. . “Si trenat e verbër ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
107 . “Kur teshtinë era ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave ” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”- Prishtinë, 2015

111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”– Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
116”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ” , Poezi Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
122. “Dritaret e verbëta ” , Poezi, Shtëpia Botuese”TREND” – Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016

127. “ Nëpër brigjet e kujtesës”Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
129 “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese
“TREND” – Prishtinë, 2016
130 “Përballë hijes së mollës ” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
131 “Jehu i zërave” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND” – Prishtinë, 2016
132 “Në kujtesën e pemëve ” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016
133“Më mirë një gjysmë ëndrre ” , Poezi,
Shtëpia Botuese “TREND “– Prishtinë, 2016

PËRMBAJTJA:

Le ta ndjej veten si në Tivar
Cikli i parë.....*11*

2.....*14*
3.....*15*
4.....*16*
5. .....*17*
6.....*18*
7.....*19*
8.....*20*
9.....*21*
10.....*22*
11.....*23*
12. .....*24*
13.....*25*
14.....*26*
15.....*27*
16.....*28*
17. .....*29*
18.....*30*
19.....*31*
20.....*32*
21.....*33*
22.....*34*
23.....*35*
24.....*36*

25.....*37*

Por vetëm dy gjysma
Cikli i dytë.....*39*

Çfarë të bëj me dorën e djathtë.....*41*
Ia huazova gjysmës së sterrës.....42
Por vetëm dy gjysma.....43
Ishte ajo gjysma tjetër.....44
Kurse ti i doje vetëm tërësitë.....45
Këto çaste të përgjysmuara.....46
Nuk e ka tërësinë e saj.....47
E verdha ishte përzier me të kuqen……48
Merre gjysmën tënde të humbur.....49
Më mirë një gjysmë ëndrre.....50
Po qe se bashkohen të dy gjysmat.....51
Takoj njerëz me sy të vithisur.....52
E tërë fusha e mëllenjave.....54
Nëpër raftet e pluhurosur.....55
Thoshte se ka vetëm një atdhe……56
Po nën atë pemë.....57
Sytë e përgjumur të agullimës.....58
I tërë vathi dimëron.....59
Para se të shkunden gështenjat.....60
Këto shkurre të atdheut tim.....61
Me telat e tendosur të kitarës.....62
Megjithatë këto vrizma shiu.....63
Sërish një hije e lëngët.....64

Dëgjoj vetëm zëzëllima zërash.....65
Çfarë po ndodh me shtrezet e ngrira.....66
Turtujt dalin maleve.....67
Lisat janë aq të mençur.....68
I prekin zogjtë në fluturim.....69
Nga puset e akullta të reve.....70
Në pasqyrën përbrenda meje.....71

Vizatuam një bukë në mur
Cikli i tretë.....*73*

Ngjante që në netët e festave.....75
Doli në bejleg shpendi dykrenor.....76
Fshihej vdekja e pashpjegueshme.....77
Nën çatitë e rrënuara çiftëzohet sterra.....79
Ky sorrak i sojit të sorrakëve.....80
Në qindra fregmente frike……..…81
Vizatuam një bukë të madhe në mur……..…82
Të jen pakë më ndryshe se ne…….....84
Fjala.....85
S'ka më shtëpi në këmbë.....86
Asnjë plumb në botë.....88
Nuk ka ikje nga kjo tokë e përgjakur.....89
Më mbaj për dore o vëlla.....90
Por ne kemi nevojë për pushkë o vëllezër.....91
Besoj se nuk mbani hidhërim.....92

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Më mirë një gjysmë ëndrre / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : “Trend”, 2016. – 106 f. ; 21 cm. -

Shënime për autorin : f. 93-102

ISBN 978-9951-694-52-0